



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 538/10 Prot.

Tiranë, më 24 . 10 . 2024

V E N D I M

Nr. 270, Datë 24 . 10 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 71, datë 05.04.2024¹, e z. S.F² kundër Shoqërisë së Transportit “Diomela” sh.p.k³, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me datë 03.04.2024 në orën 06.30, kam hipur në autobuzin me targë AB859LY të linjës Gramsh-Kamëz-Gramsh në qytetin e Cërrikut për tu kthyer në Tiranë. Pasi kam hipur në autobuz me vjen fatorino për të marrë lekët e biletës e cila ishte një grua, nxorra lekët dhe librezën e verbërisë, kisha 2000 lekë të reja dhe i thashë që jam i verbër dhe duhet të udhëtoj me 50% të vlerës, fatorino më tha jo, duhet të paguash biletën e plotë sepse ne nuk e njohim librezën, jam privat, autobuzin e kam blerë me lekët e mia dhe nëse nuk e paguan biletën e plotë unë të zbres në tokë. I kërkova biletë, dhe më tha nuk kam, nuk na ka pajisur shteti me bileta. Më mbajti lekë për biletën e plotë 400 lekë të reja”.

¹ Ankesa është plotësuar me identifikimin e subjektit kundër të cilit është bërë ankesa, me shkresën e dërguar nga DPSHTRR, nr. 6741/1, datë 15.04.2024.

² Referuar Librezës së Verbërisë nr. 06251, datë 15.06.2012, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, z. S.F është i verbër Grupi i I-rë, me afat përgjithmonë.

³ NUIS K96615802E.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për eliminimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tij, nga ana e Shoqërisë së Transportit “Diomela” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Në kushtet që, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Gramsh-Kamëz dhe anasjelltas, me të cilën kishte udhëtuar në datën 03.04.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 538/1, datë 09.04.2024, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr. 6741/1, datë 15.04.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: *“Drejtoria e Përgjithshme e*

Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhërit Nr. 318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave për operimin në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus. Nga verifikimi në sistemin elektronik e-DPSHTRR, rezulton se mjeti me targë AB859LY është në pronësi të subjektit “DIOMELA” sh.p.k, e cila operon në linjën e transportit ndërqytetas të udhëtarëve Gramsh-Kamëz-Gramsh”.

- Pas marrjes dijeni nga ana e DPSHTRR, lidhur me subjektin privat, Shoqërinë “Diomela” sh.p.k, i cili kishte në pronësi mjetin me targë AB859LY; nëpërmjet shkresën nr. 538/3, datë 22.04.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtime nga subjekti, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion nga ana e Shoqërisë “Diomela” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
 - Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Diomela” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.
 - Kopje të licencës të Shoqërisë “Diomela” sh.p.k.
 - Kopje të certifikatës për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse të mjetit me targa: AB859LY.

Në mungesë të përgjigjes nga Shoqëria “Diomela” shpk, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 538/4, datë 03.06.2024, ka rikujtuar Shoqërinë me kërkesën për informacion.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 538/5, datë 07.06.2024, Shoqëria Diomela shpk, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Me datë 03.04.2024, në mëngjes po kryeja linjën me itinerar të përditshëm Gramsh-Kamëz. Në qytetin e Cërrikut më ngrej në dorë disa qytetarë për të ardhur dhe për të marrë shërbimin e transportit nga Shoqëria jonë. Atë ditë personi në fjalë, i cili ishte dhe hera e parë që në autobusin tonë ndodh një kërkesë e tillë, i kërkon faturinos së autobusit: a e njihni ju librezën e verbërisë, pasi jam i verbër?, duke mos e treguar atë fizikisht. Pasi personi në fjalë i kishte thënë që juve ju rimbursen shteti, dua që të ulni 50% të biletës, etj. Faturino i thotë që nuk e aplikojmë, pasi para disa muajsh ne kemi kryer një aksident automobilistik me autobus dhe s’kemi marrë asnjë subvencion nga shteti për ditët që kemi qenë pushim, plus kemi qenë të lënduar fizikisht dhe emocionalisht dhe i ka ardhur kjo përgjigje. Dhe i ka thënë që, ne shteti nuk na rimbursen biletat ndaj. Kjo bisedë ka ardhur për shkak se kemi qenë të ngarkuar emocionalisht nga ngjarja që na ka ndodhur dhe s’kemi pasur asnjë mbështetje. Aq më tepër që e di shumë mirë si funksionon, pasi në familjen time ndodhet një person me aftësi të kufizuara, i verbër dhe e di vuajtjen që i bëhen njerëzve me këto aftësi të*

kufizuara dhe po të pyesësh qytetarët e Gramshit, kushdo që ka marrë shërbim nga linja jonë e autobusit dhe na e ka treguar fizikisht librezën e invaliditetit, ai e ka marrë zbritjen nga ne, por ama kush e ka treguar fizikisht, jo kush thotë që e kam librezën dhe nuk e tregon fizikisht. Kjo është e gjitha çka ndodhur atë ditë, pak nga moskuptimi, pak nga mërzitja emocionale dhe stresi që kemi pas, kemi ardhur në këtë pikë. Duke ju kërkuar ndjesë ju si Komisioner dhe personit në fjalë që ka bërë ankesën, që e ka bërë për një grup të caktuar njerëzish, shpresoj të na mirëkuptoni dhe të jeni të sigurtë që kjo gjë nuk do të ndodhë më. Shpresoj të na mirëkuptoni që ky është një biznes i vogël familjar, i ngritur me shumë vuajtje dhe sakrifica dhe ndonjëherë mund të ketë gjëra të vogla, por që do rregullohen shumë shpejt. Dhe njëherë ju kërkoj ndjesë”.

- Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 538/6, datë 11.06.2024, ka vënë në dispozicion të palës ankuese, kopje të shkresës të dërguar nga Shoqëria “Diomela” shpk, i cili megjithë marrjen dijeni të sa më sipër, nuk ka depozituar asnjë parashtrim apo qëndrim përsa sa është informuar nga Shoqëria dhe lidhur me kërkimin e ndjesës.

Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 538/7, datë 03.09.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 09.09.2024, pranë institucionit së Komisionerit, me praninë e palës ankuese personalisht, dhe përfaqësuesit të Shoqërisë, z. R.Xh, me detyrë Inxhinier pranë kësaj Shoqërie.

Gjatë seancës dëgjimore, palët parashtruan të njëjta rrethana e fakte si ato të komunikuar shkresërisht pranë KMD-së.

Me shkresën nr. 125, datë 10.10.2024⁴, subjekti ankues, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: “Në seancën dëgjimore, nga ana e Shoqërisë Diomela u vendos dakordësimi për zbatimin e ligjit për personat me aftësi të kufizuara, duke rënë dakord se nuk do të ndodhë më një rast i tillë, duke mos i njohur të drejtën personave të verbër, që do të përdorin këtë linjë. Duke qenë se Shoqëria merr përsipër zbatimin e ligjit, unë bie dakord për mosvazhdimin e procedurave të ankimimit”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, si dhe nisur nga fakti se vetë ankuesi, (bazuar në deklarimin e bërë me shkresën nr. 125, datë 10.10.2024), është dakordësuar se tërhiqet nga ankesa, me marrjen e masave sipërcituar nga ana e Shoqërisë, pasi ka arritur në një zgjidhje me mirëkuptim të problematikës së bashku me subjektin kundër të cilit ka paraqitur ankesën, Shoqërinë “Diomela” shpk.

⁴ Shkresa është dorëzuar me procesverbal, pranë zyrës së Komisionerit, në datë 17.10.2024, nga z. R.Xh.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 71, datë 05.04.2024, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetasit S.F, nga linja e transportit të udhëtarëve Gramsh-Kamëz dhe anasjelltas, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore⁵.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Për analogji citojmë Vendimet nr. 178, datë 04.06.2024 dhe nr. 238, datë 09.09.2024, të KMD-së.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 71, datë 05.04.2024, të z. S.F, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa⁶, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Rekomandohet Shoqëria e Transportit të udhëtarëve “Diomela” shpk, me qëllim parandalimin në të ardhmen, të situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masa për trajnimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave ligjore të parashikuara për këtë kategori.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶ Referuar shkresës nr. 125, datë 10.10.2024, të subjektit ankues.